

NË EMËR TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, Departmenti I Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Shabi Idrizi , Sek. Juridike Shpresa Hoxha , në qështjen penale të akuzurit [REDACTED] nga f. [REDACTED] Kaçanik, i akuzuar se ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 3 pika 3.2 lidhur me nenin 2 të KPK-së sipas aktakuzës së PTH-Ferizaj PP/II.nr. 307-6/15 të dt. 25.03.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor, oral dhe publik me datën 27.12.2016, në prani të përfaqësuesit të PTH-Ferizaj Agim Kuka dhe të akuzuarit [REDACTED] , muarr dhe shpalli këtë;

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

[REDACTED] nga f. [REDACTED] Kaçanik i lindur me [REDACTED] në f. [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme-automekanik, i pa martuar, gjendjes së varfër ekonomike, i papunë , me nr. personal [REDACTED] , (ishte në arrest shëpiak prej dt. 08.03.2015 deri me dt. 28.03.2015 mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me dt. 08.03.2015, rreth orës 10.30 - 10:30 në fshatin [REDACTED] Komuna e Kaçanikut- në shtëpinë tyre, pas një mosmarrëveshje me vëllain e tij të miturin [REDACTED] nga i cili kishte kërkuar që ti ndihmoj në shtyrjen e veturës, kishte filluar fillimisht një zënkë në mes tyre e pastaj, i pandehuri e ka sulmuar fizikisht, në atë mënyrë që me një mjet të fort -dërrasë, mjet ky i përshtatëshëm për ti shkaktuar lëndime e ka goditur disa herë në kokë dhe pjesë të ndryshme të trupit duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë : plagë prerës në regjionin e pjesës së sipërme të kokës me madhësi rreth 5-8 cm, gjak mbledhje nënlëkure në regjionin e shpinës, me pasoja të përkohshme për shëndetin,-

Me këtë veprim kreu veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 3 pika 3.2 lidhur me par 2 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me dispozitat e nenit 3, 11, 15, 41, 45,47,,neneve 73,75, 83 të KPK dhe nenit 365 , 453 dhe 463 të KPPK-së e

G J Y K O N

Të pandehurit [REDACTED] shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 50 ditësh në të cilin do i llogaritet koha e kaluar në arrës shtëpiak prej dt. 08.03.2015 deri me dt.28.03.2015 kurs epjesa e mbetur i shëndrrohet në urdhër

për punë në dobi të përgjithshme në kohëzgjatje prej 64 orëve punë i cili do ekzekutohet në afat prej një viti pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 69 të KPPK-së, konfiskohet corpus delicti i sekuestruar.

Udhëzohet i dëmtuari që kërkesën pasuroro-juridike ta realizoj në kontest civil

Obligohet i pandehri në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj taksën gjyqësore në lartësi prej 40 euro.

A r s y e t i m

PTH nga Ferizaji, me akin akuzues .PP/II. Nr. 307-6/15 të datës 25.03.2015 të akuzuarin [REDAKTUAR] nga f. [REDAKTUAR] Kaçanik e ka akuzuar për shkak veprës penale lëndim I lehtë trupor nga neni 188 par 3 pika 3.2 lidhur me nenin 2 të KPK-së.

Në shqyrtimin fillestar gjyqsor Prokurori shtetror pranë PTH-Ferizaj Agim Kuka mbeti në tërsi pranë aktit akuzues të paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate pa ndryshime dhe plotsime, duke propozuar gjykatës që të akuzuarin [REDAKTUAR] të e shpall fajtor për veprën penale që akuzohet dhe ti shqiptojë denim meritor sipas ligjit .

I akuzuari [REDAKTUAR] në mbrotjen e tij në shqyrtimin fillestar gjyqsor në tërsi e ka pranuar kryerjen e veprës penale që i vëhet në barrë sipas aktit akuzues, është i penduar dhe propozon që gjykata të i shqipton denim sa më të butë.

Pasi që gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprat penale që i vëhen në barrë dhe është e bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare duke u mbështetur në nenin 248 të KPPK-së edhe në faktet dhe provat që përmbajnë akti akuzues por edhe në shkresat e lendes, ka gjetur se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 248 par 4 të KPPK-së dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa adminstrimin e provave tjera .

Gjykata ka vlersuar se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale lëndim I lehtë trupor nga neni 188 par 3 pika 3.2 lidhur me nenin 2 të KPK-së, për të cilat vepëra penale i akuzuari është penalishtë përgjegjës dhe është ndeshkuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjës së denimit gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 75 i KPK-së të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka marrë për bazë pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit, pendimin e tij, sjelljen e mirë të tij gjatë tërë procedurës si dhe në shqyrtimin fillestar, faktin e afërsisë familare me të demtuarin dhe se është person që përkujdeset për të demtuarin, kurse për bazë për llojin dhe lartsin e denimit ka marrë parasysh, efekti do arrihet edhe më këtë denim, ndërsa rrethanë

rënduese se kjo veper penale është e drejtuar kundrejt të personave që gzojnë që mbrotje ligjore të veqantë.

Gjykata është e bindur se denimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e pergjegjise penale dhe peshën e vepres penale, keshtu që denimi i shqiptuar në lartësi si në dispozitiv të aktgjykimit , do arrihet qëllimi i denimit i paraparë me nenin 41 të KPK-së dhe atë efektin rehabilitues dhe pengues tek kryersi, efektin preventiv në mjedis si dhe reagimin shoqror ndaj kësaj dukurie negative dhe të ndeshkushme.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures dhe kompenzimin e pales së dëmtuar është i mbshtetur në dispoziten e nenit 453 dhe 463 të, KPPK-së ,

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P. nr. 130/15 ,me dt. 27.12.2016

Sek. Juridike,
Shpresa Hoxha

Gjyqtari
Shabi Idrizi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi , pala e paknadhur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

REPUBLICA E KOSOVES
DEGA E GJYKIMIT I PËRITFUGJESHM
GJYKATA E PRAVNOSMAZNA
E GJYKATËS THEMELORE FERIZAJ-DEGA NE KACANIK
27.12.2016

